

Tarih / Datë	18.12.2018
Kime / Për	z.Hilmi Jashari, Avokati i Popullit
Kimden / Nga	Cengiz Kovaç, Kosova Genç Birlik Derneği Başkanı/ Kryetari i Shoqata Unioni Rinor i Kosovës
Konu / Tema	Inicimi procedurave për ndryshimin dhe plotësimin Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 2014/01

Kërkojmë iniciimin e procedurave të ndryshimit dhe plotësimit të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të nënkryetarëve në Komuna, nga organi sponsorizues - MAPL, me qëllim të harmonizimit të Udhëzimit Administrativ me dispozitat të Ligjit për vetëqeverisje lokale si dhe me dispozitat e Kushtetutës.

Kërkesa në fjalë bazohet në dispozitat e:

- Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale;
- Udhëzimit Administrativ MAPL Nr. 2014/01 Për Procedurën e Emërimit të nënkryetarëve në Komuna;

Me Nenin 62 (paragrafi 1 dhe 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet që:

“Në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve”.

“Postin e zëvendëskryetarit do ta mbajë kandidati që i përket popullatës që nuk është shumicë, që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvendin e komunës”.

Gjithashtu, edhe me Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, përkatësisht me nenin 61, është përcaktuar që:

“Komunat ku të paktën 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë do të kenë një nënkryetar për komunitete”.

Ndërsa me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të nënkryetarëve në Komuna, përkatësisht me nenin 6 paragrafin 2 të tij është përcaktuar që:

*“Nënkryetari i komunës për Komunitete emërohet nga radhët e komunitetit jo shumicë, i cili për nga numri përbën **komunitetin jo shumicë më të madh në komunë**”.*

Duke u bazuar në dispozitat e lartcekura kushtetuese dhe ligjore, konsideron që paragrafi 2 i nenit 6 të Udhëzimit Administrativ të lartcekur, përkatësisht, formulimi *“i cili për nga numri përbën komunitetin jo shumicë më të madh në komunë”* është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale si dhe me dispozitat e Kushtetutës.

Me këto propozoj që Avokati Popullit të inicioj ndryshimet dhe plotësimet të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 2014/01 për Procedurën e Emërimit të nënkryetarëve në Komuna, nga organi sponsorizues - MAPL, me qëllim të harmonizimit të Udhëzimit Administrativ të lartcekur me dispozitat e lartcekura të Ligjit për vetëqeverisje lokale si dhe me dispozitat e Kushtetutës, më qëllim që të deblokoen edhe zgjedha nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve në Prizren, Gjiilan, Dragash dhe në komuna tjera.